



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201600734/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda :** *Rekomandohet nxjerrja e aktit për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrative, Urdhërit Nr.1776, datë 22.12.2015, si dhe;*

*Marrja e masave të menjëhershme për regjistrimi e titullit të pronësisë, Vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë Nr.607, Datë 02.05.2013, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, si dhe lëshimin e dokumenteve të pronësisë subjektit pronar.*

**Drejtuar :** **Ardiana Shehu**  
Regjistruese e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme,

**SARANDE**

**Për dijëni :** **Ministrisë së Drejtësisë**

**Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të pasurive të Paluajtshme**  
Z.Illirjan Muho

**B.P**  
Adresa:

**SARANDË**

Zj.Regjistruese!

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetasit Balil Proda, në të cilën prezantohet shqetësimi për mosekzekutimin nga ana e organit që ju përfaqësoni, të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr.607, datë 02.05.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Gjirokastër, me Vendimin nr. 508, datë 10.10.2013, për të cilin është lëshuar urdhëri i ekzekutimit me Vendimin nr.2453, datë 10.12.201, prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, me objekt :

*“Pranimin e padisë së paditësit Xh.P.*

*Ndryshimin e Vendimit nr.359, datë 01.08.2012, të AKKP, Tiranë, si më poshtë: Njohjen e të drejtës së pronësisë duke u kthyer fizikisht trashëgimtarëve të ish-pronarit Sh.P., sipërfaqen e kullotës prej 131.6dy, si dhe sipërfaqen e tokës bujqësore prej 242.4 dy në Komunën Vergo të Rrethit Delvinë, sipas parcelave, kufizimeve, gjendjes kadastrale dhe pozicionit hartografik të përcaktuar në planvendosjen e aktit të ekspertimit të ekspertit Vangjel Valera depozituar në dosje”.*

Me rastin e marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor të sipërcituar, rezulton se, ankuesi, ka kërkuar (aplikimi nr. 6518-6521, Datë 30.12.2013) regjistrimin dhe lëshimin e dokumentave të pronësisë për pasurinë e fituar në pronësi sipas titullit të pronësisë, Vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë nr. 607, datë 02.05.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë. Edhe pse afati i përcaktuar në *“Listën e shërbimeve në ZVRPP”* është konsumuar, gjykojmë se, pa shkak nuk është bërë dhe nuk bëhet e mundur regjistrimi i titullit të pronësisë së lartpërmendur si dhe lëshimi i dokumenteve të pronësisë subjektit pronar, mbi pasurinë e fituar në pronësi sipas Vendimit Gjyqësor Civil nr. 607, D02.05.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë.

Referuar akteve të vëna në dispozicion prej ankuesit, rezulton se, me shkresën nr.204 Prot, datë 07.12.2015, Zyra e Përmbartimit, Sarandë, ka lajmëruar ZVRPP, Sarandë, për detyrimin e vendosur duke caktuar me këtë rast, në referim të parashikimit të nenit 517 të K.Pr.C, afatin 10 ditore për zbatimin në mënyrë vullnetare të detyrimit.

Në përgjigje të detyrimit të bërë me dije prej Zyrës së Përmbartimit, Sarandë, ju Zj.Regjistruese, me shkresën nr.8376/2 Prot, datë 31.12.2015, drejtuar përmbartuesit gjyqësor të çështjes, z.Erjon Bejko, justifikoni moszbatimin e detyrimit të vendosur sipas Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr.607, datë 02.05.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, me pretendimin se ;

*“... pasi ka dal Urdhëri nr.1776, datë 22.12.2015, i Regjistruesit për pezullimin e regjistrimit dhe vendosjen e masës së kufizimit në zbatim të Shkresës Nr.1074 Prot, datë 04.03.2015, të Task-Force pranë Kryeministrisë “Për verifikimin e ligjshmërisë dhe mënyrës së tjetërsimit të pronave të palaujtshme shtetërore” drejtuar ZQRPP, Tiranë, në lidhje me pronën e ish-pronarit Sh.P., përfituar në bazë të Vendimit nr.23-2013-978(607) të , Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë. Eshtë njoftuar vetë pala në lidhje me urdhërin e pezullimit të regjistrimit dhe vendosjen e masës së kufizimit nr.1776, datë 22.12.2015, me shkresën nr.898/1 Prot, datë 22.12.2015”.*

Referuar pjesës arsyetuese të Urdhëri nr.1776, datë 22.12.2015, konstatohet se, ju zj.Regjistruese, justifikoni nxjerrjen e Urdhërit, në zbatim të Shkresës nr.2152/1 Prot, datë 10.03.2015, të ZQRPP, Tiranë, drejtuar ZVRPP, Sarandë, për marrjen e masave të menjëhershme në zbatim të rekomandimeve të përcjella me shkresën nr.1074 Prot, datë 04.03.2015, prej Task-Force pranë Kryeministrisë *“Për verifikimin e ligjshmërisë dhe mënyrës së tjetërsimit të pronave të palaujtshme shtetërore”*, drejtuar ZQRPP, Tiranë, në lidhje me pronën e ish-pronarit Sh.P., përfituar në bazë të Vendimit nr.23-2013-978(607) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë. Veprimet dhe procedura e kryer prej jush, zj.Regjistruese, në përmbushjen e detyrimit të vendosur nga gjykata, e vlerësojmë aspak profesionale dhe në shkelje të së drejtës së pronësisë, cënimit të parimit për zhvillimin e një procesi të regullt ligjor sikurse sanksionuar dhe garantuar respektivisht

nga nenet 41 dhe 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë apo nenet 6/1 të Konvetës Europiane e të Drejtave të Njeriut (miratuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996), nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konvetës, si rrjedhojë e mosmarrjes së masave në afatin e vendosur për regjistrimin dhe lëshimin e dokumenteve të pronësisë në favor të subjektit pronar. Funksionimi i organit që ju përfaqësoni në zbatimin të vendimit gjyqësor në fjalë, konstatohet se, nuk vjen gjithashtu në respektim të parimit të ligjshmërisë, parimit të mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave private, të parashikuara në nenin 9 dhe 10 të Kodit të Procedurës Administrative dhe detyrueshme në kuptim dhe zbatim të nenit 1 të këtij Kodi.

Si shkak ligjor, i cili justifikon në vlerësimin tuaj, nxjerrjen e aktit, Urdhërit nr. nr.1776, datë 22.12.2015, është parashikimi i kryer në nenin 59 dhe 75 të Ligjit Nr.33/2012, *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*.

Sipas parashikimeve të kryera në nenet 59 dhe 75 të ligjit nr.33/2012, *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, të ndryshuar, nuk flitet për pezullimin e veprimeve për regjistrimin e titullit të pronësisë, por për *“Regjistrim të kufizimeve”* si dhe *“Dispozita kalimtare”*. Pezullimi i veprimeve për regjistrim të titullit të pronësisë parashikohet në nenin 40 të ligjit nr.33/2012, të ndryshuar, i cili ndodh vetëm nëse mbajtësi i një të drejte pronësie apo i një të drejte tjetër reale të një pasurie të paluajtshme ka të drejtë të kërkojë pezullimin e kryerjes së veprimeve të regjistrimit nga regjistruesi, në bazë të një akti noterial, që kushtëzon këto veprime për aq kohë sa përcaktohet në këtë akt. Fakti që asnjë prej *trashëgimtarëve të ish-pronarit Sh.P., nuk ka kërkuar ZVRPP, Sarandë*, pezullimin e kryerjes së veprimeve për regjistrimin e, Vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë nr. 607, datë 02.05.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, pas sjell pavlefshmërin absolute të Urdhërit nr. 1776, datë 22.12.2015, në kuptim dhe zbatim të parashikimeve të nenit 108/ii të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*. Për rrjedhojë, referuar parashikimeve të nenit 111 të ligjit nr.44/2015, në të cilin thuhet se;

*“Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi”*,

Qëndrimi i mbajtur prej organit që ju përfaqësoni, në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 1208, datë 16.07.2014, ka cënuar dhe cënon marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, të cilat sigurojnë jo vetëm veprimtarinë e rregullt të organit që ju përfaqësoni, por dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve apo të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal kundër veprimeve ose mosveprimeve kriminale.

Funksionimi i organit që ju përfaqësoni në zbatimin e këtij vendimi gjyqësor, konstatohet se, nuk vjen në respektim të parimit të ligjshmërisë, drejtësisë dhe paanësisë, objektivitetit, përgjegjësisë, drejtave të personave private, të parashikuara në nenin 4, 13, 14, 15 të Kodit të Procedurës Administrative dhe detyrueshme në kuptim dhe zbatim të nenit 1 të këtij Kodi.

Qëndrimin e derisotëm të mbajtur nga ana juaj e vlerësojmë në cënim të së drejtës së pronësisë, parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor në një afat ligjor të arsyeshëm sikurse sanksionuar respektivisht në nenin 41, 42 të Kushtetutës, nenin 6/1 të Konvetës Europiane e të Drejtave të Njeriut (miratuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996), nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konvetës,

pra, mosmarrjes së masave në afatin e vendosur për regjistrimin dhe lëshimin e dokumenteve të pronësisë në favor të subjektit ankues.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problemi çmon me vend të bëjë këtë rekomandim, duke shpresur se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës të shkelur ankuesit në fjalë.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, i cili parashikon se : “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

### **REKOMANDOJMË**

*Nxjerrjen e aktit administrative për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Urdhërit nr.1776, datë 22.12.2015, “Për pezullimin e regjistrimit dhe vendosjen e masës së kufizimit”.*

*Marrjen e masave të menjëhershme për regjistrimi e titullit të pronësisë, Vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë nr.607, datë 02.05.2013, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, si dhe lëshimin e dokumenteve të pronësisë subjektit pronar.*

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

*Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERI**

**Etilda GJONAJ(SALIU)**

**Konceptoi dhe Daktiligrafoi  
A.Gjoleka**